

MOTIVET E KTHIMIT TË SHPEJTË TË KOSOVARËVE NË TROJET E VETA, 1999

*Kur arsyeja fillon përsëri të flasë,
Edhe shpresa përsëri fillon të lulëzojë.*

GËTE

Hyrja

Vitet 1998-1999, në Kosovë, janë vërtet më të përgjakshmet, por më heroiket në historinë e saj. Me mijëra burra, pleq, gra e fëmijë u gjymtuan, u vranë, u masakruan, u therën e u përdhunuan. Shtëpitë u dogjën dhe pasuria u rrënuar e u grabit. Sipas agjencive të huaja, mbi 800.000 shqiptarë u dëbuan nga trojet e tyre shekullore, kurse 600 mijë u endën maleve të Kosovës për të shpëtuar nga torturat, përdhunimet dhe vrasjet e ushtrisë së paramilitareve serbë. Kemi pasur rastin t'i shohim vetë me sytë tanë dyndjet biblike... ku jemi mbështetur për punimin. Barbaria në situata luftërash është shfaqur si një epidemi. Kështu ndodhi edhe me shqiptarët e Kosovës në vitet 1998 e 1999, të cilët përballë kishin një shtet militar që historikisht njihet si një shtet, indet e të cilit janë ngritur mbi "hormonet" e dhunës dhe barbarisë.

Lufta u kthye në një dimension të frikshëm për shqiptarët në Kosovë. Ata reagues nëpërmjet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe manifestuan botërisht ndërgjegjen e tyre kombëtare në forma të tjera të qëndresës. Bota u trondit nga krimet makabre të serbëve... Bota u befusua nga pritja shqiptare, e vëllait për vëllanë. Kukësi, e shumë qytete të tjera shqiptare u bënë epiqendër e medias botërore në ato ditë të eksodit kosovar. Por, bota u befusua edhe me kthimin e shpejtë të kosovarëve në trojet e tyre.

Qarqet shovene serbe, Millosheviçi dhe shtabi i tij, veç shpërnguljeve masive barbare (të cilat ai me ironi i quante

“piknik”) kishin llogaritur me siguri edhe pamundësinë e kthimit të shqiptarëve të Kosovës në Kosovë. Mjafton që të shpërnguleshin dhe krahas pushtimit ushtarako-policor, llogaritej edhe moskthimi, pamundësia për kthim, pse jo edhe prirja, frika, e dëshira për moskthim e shqiptarëve. Momenti i dëbimit të forcave ushtarako-policore serbe nga Kosova dhe i futjes së forcave ushtarake të NATO-s do të ishte edhe një sprovë e madhe për shqiptarët e Kosovës. Kishte paragjykime, sipas disave, jo të pabazuara, se ky kthim për shkak të asaj që kish ndodhur, do të ishte i vështirë e i ngadaltë, në mos edhe i pamundur. Por ky moment përbente një provë reale për shqiptarët e Kosovës. “Moskthimi” dhe “kthimi” do të ishin edhe argumente për të gjykuar të kaluarën. Moskthimi automatikisht ishte llogari e serbëve dhe politikë proserbe. Bota në këtë moment mbante frymën: po shqiptarët ç’do të bënin? Po t’i shkonte lufta dëm NATO-s, serbët do të thoshin: “E shikoni, që shqiptarët nuk kthehen! Nuk kthehen, sepse s’kanë ku të kthehen, e dinë dhe e ndjejnë se nuk është vendi i tyre”.

Bota përparimtare e demokratike perëndimore dhe përfaqësuesit e saj NATO e UHNCR etj. kishin besuar në kthimin e shqiptarëve. Prandaj ata edhe kishin hartuar një strategji për kthimin e shqiptarëve në Kosovë, strategji që kërkonte, sipas parametrave ndërkombëtarë, kohë, fonde, mjete, krijim kushtesh në Kosovë (çminim, ndërtim e riparim shtëpish etj.). Por bota që ishte çuditur herën e parë me dhunën e shtetit serb dhe me eksodin e shqiptarëve të Kosovës, tani do të çuditej me kthimin e tyre. E çfarë kthimi! Jashtë çdo parashikimi, jashtë çdo plani të ndërkombëtarëve dhe të miqve.

Eksodi i shqiptarëve të Kosovës, në vitin 1999, do të jetë objekt i madh i studimit dhe i gjykimit të historiografisë dhe shkencave të tjera shoqërore. Po ç’ishte ky kthim, ky kthim kaq i shpejtë, që i la të habitur të gjithë, madje edhe vetë shqiptarët e Shqipërisë?! Ky kthim historik, tanimë, në kuptimin e rëndësisë dhe të faktit se ai ka ndodhur para syve të gjithë botës, ky kthim, që është i shqiptarëve të shpërngulur nga dhuna serbe prej tokave e shtëpive të veta shqiptare, është një veprim i natyrshëm, i ligjshëm dhe ka shpjegimet e tij historike dhe etnopsikologjike. Ai është e do të jetë një argument i madh, sot e në të ardhmen për autoktoninë e shqiptarëve në Kosovë e më gjerë.

UNCHR, qeveria shqiptare, AFOR, KFOR, hartuan programin për riatdhësimin e kosovarëve në tri faza: përgatitja, fillimi i lëvizjes, lëvizja e mëtejshme në Kosovë. Sipas këtij plani, më 1 korrik do të fillonte rikthimi i tyre. Në thirrjen drejtuar popullit të Kosovës nga këto organizma kërkohej durim, kthim vullnetar dhe i kontrolluar. Etapat e planit u dogjën...

Sipas burimeve të OSBE-së në Tiranë, në qytetin e Kukësit që në qershor ishin boshatisur 40% e çadrave, ndërsa në kampin gjerman Kap Ampur nuk gjendej asnjë refugjat i Kosovës.

Në 8 kampingjet e Kukësit kishin mbetur 5680 persona.

Sipas UNCHR-së, çdo ditë do të riktheheshin 1-3 mijë persona. Më 30 qershor 1999, nga Kukësi kaluan 23.5000 kosovarë. Sipas ATSH-së, me datë 8.7.1999 njoftohej se vetëm 5 mijë kosovarë kishin mbetur në Shkodër, nga 44 mijë që kishte më parë. Me të drejtë, politologë, historianë, sociologë dhe psikologë, të befashuar nga rikthimi i shpejtë i kosovarëve shtruan pyetjen: Çfarë i shtyn të mos presin asnjë ditë, asnjë orë, asnjë minutë, edhe pse të rrezikuar nga minimi i kufirit, për t'u kthyer në trojet e tyre? Cilat janë mekanizmat që e bëjnë popullin e Kosovës të ruajë të pacënuar substancën etnike, hapësirën, konstitucionin shpirtëror, vetëdijen kombëtare, mbiekzistencën?

Cilat janë ato rrënjë që e kanë ushqyer vazhdimisht tokën e Kosovës për të mos u tharë kurrë gjaku shqiptar, ideali shqiptar, duke qëndruar e rezistuar krenare, e paepur në shekuj?...

1. Dashuria për tokën e të parëve, për atdheun

Poeti ynë kombëtar, Naim Frashëri shkruan:

"O Atdhe, më je i dashur sa më s'ka,
Më je nënë, më je motër, më je vëlla.
Nga ç'ke rrotull më i shtrenjtë ti më je,
Je më i miri nga çdo gjë që ka ky dhe...
Ti ke parë gjyshë-stërgjyshërit e mi,
Edhe eshtrat tretur ua ke po ti.
Nga ti, shpirt, ata kurrë nuk qenë ndarë.
Pranë teje patën qeshur, patën qarë."
(Frashëri, 1977, f. 10)

Pra, atdheu është familja, trualli i të parëve, varri i gjysh-stërgjyshërve, është gjaku i derdhur për ta ruajtur atë, është djersa për ta zbukuruar e lulëzuar, është e shkuara, e tashmja dhe e ardhmja.

Në vitin 2004, në Gjilan, u botua libri *Psherëtimë për tokën*. Alban Ajeti, nëpërmjet vargjeve të tij, solemnisht e me krenari deklaroi: “Kosovën tonë/ S’mund ta zhbëjë askush/ Se aty pushojnë eshtrat/ e gjaku i të parëve tanë” (Këqiku, 2004, f. 24). Poeti Ramadan Xhema, me zërin e tij të fuqishëm e të lartë, plot vendosmëri shkruan: “Miq dhe armiq le ta dinë/ S’mund të jetoj pa e dashur Shqipërinë/ Pa e dashur vendin dhe shtëpinë/ Pa i dashur njerëzit dhe drejtësinë” (Këqiku, 2004, f.280).

Shqiptarët e Kosovës nuk luftuan vetëm për tokën e Kosovës, por për të gjitha tokat shqiptare. Luftuan për një atdhe të përbashkët të të gjithë shqiptarëve. Për një atdhe, ku të ketë liri, barazi dhe drejtësi.

Sipas Branko Merxhanit, “Kur s’ka Atdhe, asnjë dhe s’të bëhet më Atdhe i Dytë” (Çefa, 2012, f.15).

Për historianin Marlin Barleti, “Atdheu është dashuria më sublime dhe ideali më i lartë i shqiptarit. Dashuria për Atdhe ia kalon çdo dashurie tjetër” (Çefa, 2012, f. 96).

Studiuesi Hobhouse vëren: “Asnjë vend i ri, asnjë pamje e re s’mund t’ua fshijë shqiptarëve kujtimet dhe dashurinë për malet, për miqtë dhe fshatrat e tyre. Ata në mënyrë të përvetshme u kthehen atyre (Çefa, 2012, f. 109).

Pra, lidhja e shqiptarëve me tokën është e përbashkët për të gjithë shqiptarët. Kështu ne shohim tek i ikuri në dhe të huaj, sesi i shtyrë nga malli, dëshiron gjithmonë të kthehet në atdhe (Çabej, 1994, f. 28).

Shqiptarin e dallon lidhja e ngushtë me familjen, lufta dhe përpjekjet e tij për të ruajtur nderin e saj, jetën e anëtarëve të saj. Veçanërisht, siç thotë Eqrem Çabej: “Shqiptari është për gjithë jetën i lidhur me familjen e madhe... Si familja, ashtu edhe heroizmi dhe një dëshirë e flaktë për liri janë shtysa të forta në karakterin dhe qëndrimin shpirtëror të shqiptarëve, si dhe të stërgjyshërve të tyre ilirë” (Çabej, 1994, f. 28,61).

A nuk ishin shumë nga familjarët e shqiptarëve të Kosovës që u shpërngulën me dhunë, familje të mëdha? Të shpërndarë,

dikush në Shqipëri, dikush në Maqedoni, Mal të Zi, Zvicër, Gjermani etj.... mezi pritën çlirimin e Kosovës që të bashkoheshin në trojet e tyre në Kosovë.

Në vlerësimin e Obrej Herbert, diplomat, politikan dhe ushtarak anglez, "Shqiptarët kanë qenë gjithmonë dhe janë adhures të zjarrtë të truallit e të shkëmbinjve të tyre" (Pango & Kosta, 2014, f. 236).

Studiues, psikologë, sociologë, etnologë, antropologë vendas dhe të huaj kanë folur dhe shkruar për lidhjet e forta të shqiptarëve të Kosovës me traditën. Disa gra e plaka kur ikën prej andej (të larguara me forcë, nën tytën e pushkëve e bajonetave serbe) disa qëndisje dhe sende të rralla që i kishin kujtim nga të parët e tyre, si: qilima, veshje kombëtare, qëndisje të ndryshme, i fshehën në tokë. Donin t'i shpëtonin me çdo mjet. Kjo ishte edhe një nga arsyet që i bënë të ktheheshin sa më parë në shtëpitë e tyre në Kosovë dhe pse pjesa më e madhe e tyre ishin djegur. Prirja për të ruajtur e për të ringjallur traditën, për të mos e humbur atë, në thelb shpreh qëndresë, pavdekësi. Kulti i së kaluarës është qëndresë e së sotmes dhe e së ardhmes (Tirta, 2013, f. 331-332).

Për të zhdukur traditat e shqiptarëve serbët dogjën Kompleksin e Lidhjes së Shqiptarëve në Prizren, Çarshinë e Vjetër në Gjakovë dhe 387 kulla tipike shqiptare.

Emrat që shqiptarët në Kosovë u vunë fëmijëve të tyre dëshmojnë edhe për lidhjet e tyre të thella shpirtërore me atdheun mëmë, Shqipërinë.

- Kemi emra që lidhen me simbolet tona kombëtare, si: Atdhe, Flamur, Ilir, Ilirjana, Dardan, Dardana, Skënder, Kastriot, Shqipe, Alban, Albana etj.
- Dallojmë të tjerë emra që simbolizojnë jetën, si: Jetlinda, Jetëgjata, Jetlir, Jetlira, Liridona, Qëndrim, Qëndresë, Çlirim, Lirim, Festim etj.
- Mjaft të përhapur janë edhe emrat qyteteve e trojeve etnike shqiptare, si: Dibra, Saranda, Berat, Dukagjin, Shkumbin, Drenica, Korab, Kaçanik, Rozafa, Shkodran, Lumjan, Erenik, Vlora etj.

Edhe pse në Kosovë në vitet `70 çmimet e tokës dhe të shtëpive ishin 2-3 fish më të larta se në Serbi, ku ka pasur zona që trojet kanë qenë edhe 10 fish më lirë se në Kosovë, shqiptarët e Kosovës me kursimet e tyre, me lekët e emigracionit i blenë ato nga serbët (Maliqi, 2011, f. 127-128).

I blenë ato se ishin të lidhur ngushtë me tokën, me atdheun, se e kishin ndarë mendjen se nuk do ta lëshonin vendin e tyre. Se në Kosovë kishte familje të mëdha dhe këto familje kishin nevojë për zgjerim, kurse Serbia në vitet `60 dhe `70 e kishte problemin e "mortajës së bardhë", e zbrazjes së fshatrave, të shtëpiave të pabanuara dhe tokave të lëna djerrë, sepse nuk kishte kush t'i punonte. Kjo dëshmon se serbët, malazezët nuk u larguan nga Kosova nga genocidi i shqiptarëve, siç propagandon Beogradi sot, por shkuan në Serbi, Kroaci, Slloveni dhe në Perëndim për një jetë më të mirë.

Shqiptarët e blenë më se një herë tokën e tyre nga kolonët serbë e malazezë. Faktet që jep Shaban Haxhia (Demaliaj), komandanti i Brigadës së Shtatë kosovare, të ruajtura në Arkivën e MPJ-së së Shqipërisë janë tronditëse, por të vërteta. Po e japim të plotë dëshminë e tij:

"Më 1945 filloi Reforma Agrare në Kosovë. Në fillim u fol se tokat që ishin zaptue nga reforma agrare e ish-Jugosllavisë nuk do t'u merreshin shqiptarëve, pasi kjo reformë në atë kohë kishte qënë e padrejtë dhe kishte për qëllim me zhdukë popullatën shqiptare në Kosovë e me e zëvendësue me serbë e malazezë. Komisioni që u formue nën drejtimin e Dushan Mugoshit për reformën agrare filloi që të shikonte tokat që kishin marrë serbët dhe malazezët dhe këto do t'u ktheheshin popullit, me përjashtim të atyre tokave që kishin qënë lëndinë (të papunueshme), të cilat ishin të rregjistruara mal e livadh. Që në fillim kjo nuk u zbatue dhe u shtrembëruë" (Haxhia, 1949, f 33).

Studiuesit e huaj kanë evidentuar se gjaku dhe trualli janë elementët parësorë të identitetit shqiptar. "Toka ka mbetur dashuria e ballkanasve", thotë Roberto Morozzo della Rocca. Edhe shqiptarët janë pjesë e familjes ballkanase. Është trillim i një mendjeje të sëmurë e të verbuar nga nacionalizmi serbomadharshëtim i Vlladan Gjeorgjeviçit, se "Shqiptarët emigrojnë. Serbi nuk e lëshon lehtë vendin atëror" (Gjeorgjeviç, 191 f.:42).

Studiues të huaj e kanë kundërshtuar Gjeorgjeviçin. Sipas Gucciordin, “Shqiptarët janë të lidhur ngushtë me vendin e tyre” dhe “Malësori shqiptar në mërgim, ministër qoftë apo plaçkambartës, gjeneral ose ushtar i thjeshtë... në thellësi të shpirtit të tij, në vuajtje apo në fatin më shkëlqyes, përjeton me mallëngjim, me dashuri atdheun e tij, vendin e lindjes, shkëmbinj të e ashpër që kufizojnë horizontin” (Tirta, 2003, f. 363,367).

Reforma agrare kolonizuese serbe në Kosovë kishte si objektiv marrjen e tokës shqiptare, pikërisht në ato rajone ku ata përbënin shumicën absolute. Gjatë viteve 1918-1940, në Gjakovë, u vendosën 2583 familje serbe, nga 13938, gjithsej 18.5%. Kosovari mbeti “bujk pa dhe, bari pa kope, në tokën e vet, në të cilën ishte zot që qëmot”, do të shkruante Mitrush Kuteli në veprën madhore *Poem kosovar*.

Deputeti i Kaçanikut, Zejnel Strazimiri, në vitin 1936, deklaronte: “Na mbetet vetëm detyra që të bashkohemi me popullin dhe të mbrojmë me kiza në duar tokën ku kemi le dhe të drejtat e jetës” (Strazimiri, 1936, f. 121-123).

Edith Durham shkruan: “Në gjoksin e shqiptarit... është ngulitur e ka lëshuar rrënjë bindja se toka ka qenë e tij ligjërisht gjatë të gjitha kohërave, se serbi e pushtoi, e mbajti për disa shekuj nën sundim” (Durham, 1998, f.192).

10 qershori 1999 shënon fundin e Serbisë në Kosovë. Më 12 qershor 1999 trupat e NATO-s hyjnë në Kosovë. Për Kosovën filloi një epokë e re. Kosovarët, pas një shekulli, thithën oksigjenin e lirisë.

2. Janë autoktonë në tokën e tyre dem baba dem

Edhe një pjesë e serbëve pas çlirimit të Kosovës u larguan për në Serbi. Arsyet janë të ndryshme, si më poshtë:

Kishte nga ata që ishin të kriminalizuar dhe s’mund të qëndronin në Kosovë. I druheshin hakmarrjes së shqiptarëve, por edhe dënimit për genocid, sipas ligjeve ndërkombëtare.

Nuk ishin më të privilegjuar dhe s’mund të jetonin si të barabartë me shqiptarët. Sipas mentalitetit të tyre, të rrënjësuar në shekuj ata ishin zotërit e vërtetë të Kosovës.

Nuk kishin besim se mund të bashkëjetonin me shqiptarët. Bashkëjetesën e kuptonin nga pozitën e sunduesit në Kosovë.

Shoqata për kthimin e serbëve në Kosovë “Povrata” (kthim), po përpiqet që ata të kthehen sa më parë. Nëse kjo nuk po ndodh me ritmet e kërkuara të zyrtarëve serbë, kjo nuk ndodh për shkak të presionit të shqiptarëve, por ndodh për shkak të faktit se serbët e dinë mirë se ata janë të ardhur, jo vetëm historikisht, pra edhe konkretisht vonë (mbahet mend prej brezave të sotëm). Megjithatë midis kthimit të shqiptarëve e atij të serbëve në Kosovë ka ndryshime. Shqiptarët janë autoktonë, kurse serbët u vendosën si kolonë me forcë në tokat e shqiptarëve dhe me brutalitet ua grabitën ato.

Çdokush nuk ka frikë të kthehet në tokën e tij, në shtëpinë e tij në çdo kohë e në çdo moment, në ditë gëzimi, por edhe trishtimi. Fakti që shqiptarët ktheheshin në shtëpitë e tyre, të ngritura me djersë e gjak, ktheheshin në trojet e tyre shekullore, është faktor i rëndësishëm psikologjik. E kush mund ta ndalte turrin e shqiptarëve për t’u kthyer në tokën e vet të lirë?!

Fakti që serbët ndërjuan disa manastire në Kosovë dhe disa toponime në Shqipëri janë të emërtuara në sllavish, nuk do të thotë se këto pjesë janë tokë serbe. Nuk kanë thënë ndonjëherë italianët se Durrësi është tokë italiane nisur nga fakti se atje mund të gjenden disa dokumente të kulturës romake.

Cvijiçi, Tomiçi, Haxhivasiljeviçi, Urosheviçi, Shepsheviçi, Bogdanoviçi, kanë servirur tezën se islamizmi në Kosovë është një dukuri që u përket kryesisht shekujve 18-19 dhe që lidhet me “eksoodin shqiptar” nga malësitë e Veriut drejt tokave të Kosovës dhe Maqedonisë Perëndimore. Edhe Çubrilloviçi mbronte tezën se “shqiptarët zbritën nga malet e tyre dhe u vendosën në fushat pjellore të Metohisë e të Kosovës” (Çubrilloviçi, 1981, f.19).

Duke iu kundërvënë kësaj teze antihistorike e antishkencore, Prof. Eqrem Çabej thotë: “Do të ishte një dukuri përjashtimore që një shpërngulje dhe një ngulim i një populli të tërë, i kryer brenda sferës së botës romake e greke e në dritë të plotë të historisë të ketë ndodhur pa u vënë re prej historianëve (Gosturani, 1999, f. 31).

Studiuesi serb Kostandin Jereçek, e pranon në librin *Historia e Serbisë* se “Kosova u pushtua nga serbët në shekullin XII” (Delvina, 2000, f. 17).

Sipas historianit anglez Noel Malcolm, “Serbët tregojnë histori të manipuluar kur thonë se Kosova është djepi i serbëve.

Në fakt Kosova është pushtuar nga serbët në shekullin XII". Në këtë këndvështrim duhen parë dhe trajtuar edhe përpjekjet e studiuesve serbë për restaurimin e shtetit të madh të mesjetës brenda kufijve të tij të vjetër. Në realitet këta kufij s'janë veçse një mit historik serb. Po të kishin qenë një perandori e madhe, ata nuk do të kishin marrë fund së ekzistuari, ashtu siç ngjau aq shpejt, në vitin 1389" (Delvina, 2000, f. 12).

Edhe Drashkoviçi i bashkohet korit të falsifikatorëve serbë, kur thotë: "Shkenca vlerëson se së paku gjysma e popullsisë së Shqipërisë së sotme dhe 3/4 e gjithë shqiptarëve në Rrafsh të Dukagjinit, dhe në Kosovë kanë rrënjë serbe" (Kadare, 2002, f.10).

Pikërisht se mbron këtë tezë antihistorike, Drashkoviçi bën thirrje, hapur: "Duhet të luftojmë për të gjitha ato toka të Jugosllavisë, ku të ketë një varr serb" (Grup autorësh, 2002, f. 263).

Me termat e nacionalizmit serb Kosova do të cilësohet si "plagë kanceroze në trupin e shëndoshë të Serbisë". Lëvizja nacionaliste serbe (ku dekadat e fundit dallohen personalitete politike e shkencore, si Drashkoviçi e Qosiçi - shënimi ynë) do të frymëzojë procesin e "mëkëmbjes së një populli", "hyrjen e tij në histori" në mënyrë që të korrigjohen "padrejtësitë historike" dhe "tradhtia" (Kullashi, 1995, f.126).

Studiues të huaj e shqiptarë, madje edhe vetë burime serbe e pranojnë autoktoninë e shqiptarëve në Kosovë. Burimet mesjetare kishtarë sillave dëshmojnë se në Kosovë shqiptarët gjithmonë ishin shumicë.

Kodi i Stefan Dushanit si dhe krisobulat e sundimtarëve serbë për kishat dhe manastiret e tyre, të vëna në qarkullim nga autorë serbë, si S. Novakoviçi dhe M. Diniç, i përmendin shqiptarët - arbanas banorë në këto troje në Shqipërinë Verilindore e Lindore deri në Shkup e Tetovë e të tjera vise, një shekull e pak, para vendosjes së sundimit osman në këto anë.

Georg Fon Han, në librin *Udhëtim nga Beogradi në Selanik* (1866), u njeh shqiptarëve shumicën e pakontestueshme, si në fushën e Kosovës e deri në brigjet e lumit Vardar dhe në Shkup. "Këta shqiptarët, - thotë ai, - janë banues autoktonë në këto anë" (Grup autorësh, 1995, f.139).

Sipas albanologut të madh Norbert Jokli, *Djepi i popullit shqiptar është Dardania* (Çabej, 1987, f. 39). Për Prof. Çabejn, "Vendbanimi i shqiptarëve nuk është një zonë ekspansioni, por

një zonë restrikcioni, përfundim i një ngushtimi të paprerë gjatë historisë së tyre” (Çabej, 1987,f. 40), kurse Prof. Shaban Demiraj shtron pyetjen: “Me çfarë popujsh bien në kontakt fiset sllave kur u vendosën në Gadishullin Ballkanik?” dhe përgjigjet: “Sipas shumë dijetarëve, në këto vise ata erdhën në kontakt me një popullsi pjesërisht të romanizuar dhe pjesërisht të paromanizuar dhe këta të fundit, sipas tyre ishin stërgjyshërit e shqiptarëve të sotëm” (Demiraj, 1999,f.64).

Edith Durham thotë se “Fusha e Kosovës është shqiptare...

Shqiptari ka zënë qendrën e vilajetit të Kosovës. Serbët janë me shumicë vetëm përgjatë kufirit serb dhe afër kufirit malazes, veçanërisht rreth Beranës dhe Pejës” (Durham, 1998,f 193-194).

Për Tucoviçin, “Gjakova është qytet thjesht shqiptar... nuk është qytet shqiptar vetëm për nga raporti numerik i popullsisë, ajo është shqiptare për nga jeta e gjithëmbarshme e jashtme si dhe ekonomike... Gjakova bie në sy pikërisht sepse në të, gjithë zejtaria dhe gjithë tregtia është në duart e vetë shqiptarëve... Çarshia shqiptare në Gjakovë nuk ka asgjë të përbashkët me Çarshinë turke” (Tucoviç, 1981, f. 192-193).

3. Shqiptarët e shpërngulur nga Kosova qëndruan përkohësisht në Shqipëri

Nisur nga ngjarjet e vitit 1997, 1998 në Shqipëri, regjimi i Millosheviçit besonte se Shqipëria nuk kishte mundësi t’i mbante kosovarët e shpërngulur me forcë, e ata do të degdiseshin nëpër Evropë e më tutje saj. Ai shpresonte edhe në mbështetjen e disa qarqeve të ekstremist të djathtë në Evropë që do ta ndihmonin në planin e tij për spastrimin etnik në Kosovë. Parashikimi i Millosheviçit dështoi. Kosovarët u strehuan në shtëpitë e vëllezërve të tyre në Shqipëri, me shpresën se së shpejti do të ktheheshin në vatrat e tyre. Mikpritja është një çështje nderi për shqiptarët. Sipas studiuesve të huaj ku është rreziku më i madh, atje ndihma e shqiptarit është më afër. Pikërisht në ditët e vështira e tragjike për popullin vëlla kosovar, shqiptarët, në Shqipërinë e Vjetër, hapën dyert e shpirtit e të zemrës dhe nuk morën parasysh as rreziqet, as shpenzimet e vështirësitë.

Craig Juriseviç, në librin *Duart e përgjakura, kirurgu në luftë*, botuar në Prishtinë, në vitin 2012, nga shtëpia botuese “Koha”, e shtrembëron me qëllim këtë të vërtetë të madhe. Në librin e tij, ai është dashakeqës për bujarinë dhe sakrificat e banorëve të Kukësit

dhe shkruan në shërbim të serbëve.

Mjeku humanist dhe atdhetar kuksian Mersin Braha, në librin e tij *Misioni i djallit* (Misteri i një kirurgu sllavo-australian), e ka hedhur poshtë me argumente librin e tij. Ai i quan shpifje thëniet e tij dhe misionin e tij djallëzor, të dyshimtë dhe në shërbim të qarqeve antishqiptare.

Craig Juriseviç, shkruan në librin e tij se “Shqiptarët nuk i duan kosovarët. Shumë shqiptarë mendojnë se po u bëhet mirë... Refugjatët që vuajnë këtu trajtohen si qentë” (Juriseviç, 2012, f. 41). Ai e krahason jetën e tyre me Ferrin e Dantes, por me dallim që këta njerëz nuk po dënohen për mëkatet e tyre (Juriseviç, 2012, f. 62). Flet edhe për pashpirtësinë, me të cilën trajtohen kosovarët në Kukës (Juriseviç, 2012, f. 114).

Jep rastin e vdekjes së një fëmije 18- muajsh, sepse sipas tij, mjekët lokalë refuzuan t’i jepnin antibiotikë dhe oksigjen (Juriseviç, 2012, f. 127). Në të vërtetë, në spitalin e Kukësit, nga 27 marsi 1999 deri më 12 qershor, nuk ka vdekur asnjë fëmijë, as i ardhur nga Kosova, as vendas.

Për t’i hedhur poshtë akuzat e tij, mjeku Mersin Braha citon vlerësime të personaliteteve të huaja:

- Zhak Shirak, Presidenti i Francës: “Në rast se Franës do t’i duhej të pranonte rreth 800 000 refugjatë në një periudhë kohore aq të shkurtër (79 ditë), ajo do të gjendej në prag falimentimi, (Braha, 2013, f. 93). Kukësi i vogël, por me zemër të madhe sa mali i Gjallicës e përballoi me sukses”.
- Një kolege angleze, Tereza më tha: “Ju shqiptarët jeni një komb tejet i veçantë në botë. S’gjen askund si ju. Vetëm ju shqiptarët po e bëni këtë sakrificë, po e bëni atë që asnjë popull në botë nuk e ka bërë” (Braha, 2013, f. 168).
- Lena, kolege angleze: “E gjithë bota i ka kthyer sytë nga Kukësi e nga Shqipëria, shembull humanizmi dhe bujarie të jashtëzakonshme që me një popull 20 mijë banorë po strehon, po ushqen dhe po i shërben një popullsie të ardhur që është 5 herë më e madhe” (Braha, 2013, f. 168).

Në Gjermani, Angli, Turqi, SHBA dhe vende të tjera europiane (përfshirë edhe Bosnjë-Hercegovinën) që nuk janë në kufi me Kosovën, u strehuan 98 175 refugjatë të Kosovës (Grup autorësh, 1999, f. 52). Në Shqipëri u vendosën 402 262 refugjatë, në

Maqedoni 247 800, në Mal të Zi 69 300, gjithsej 719 362 refugjatë. Në të gjitha këto vende, kosovarët ishin në kufi me Kosovën, afër vendbanimeve të tyre. Pra, nuk u duhej shumë kohë për t'u kthyer në shtëpitë e tyre, pasi largësia nga vendbanimet nuk ishte e madhe dhe të gjitha pikat e kalimit ishin të lira dhe në dispozicion të tyre. Një pjesë e madhe e shqiptarëve të Kosovës, rreth 600 000, ishin fshehur në malet e pyjet e Kosovës. Me të marrë lajmin e çlirimit të Kosovës, ata u kthyen në shtëpitë e tyre, se nuk u rrezikohej më jeta dhe pasuria nga pushtuesi serb.

Nuk ishte rastësi për kosovarët qëndrimi i tyre në shtetin amë. Ishte një mundësi më shumë për t'u kthyer shpejt në vendin e tyre. A nuk ndodh kështu edhe me bletën?! Pasi del nga kosherja, po të largohet shumë ajo nuk do të kthehet më, kurse po të lidhet në ndonjë pemë afër, kthehet përsëri në follenë e saj të mëparshme.

Shqiptarët e Kosovës u rikthyen edhe nga vendet e tjera, ndonëse atje mund të kishin më pak telashe e mund të ishin më mirë ekonomikisht.

Populli thotë: "Guri peshon rëndë në tokën e vet". Malli dhe dashuria për atdheun është mbi gjithçka.

4. Shqiptarët e Kosovës janë njerëz të sakrificës

Për shqiptarët e Kosovës nuk ishte hera e parë që u digjeshin kullat, që vriteshin dhe përziheshin me dhunë nga tokat e tyre. Gjatë konfliktit në Kosovë pati shumë dëme materiale. U dëmtuan 119.500 shtëpi, 534 shkolla (189 prej tyre të shkatërruara plotësisht), 240 qendra shëndetësore. (183 të shkatërruara plotësisht). Rrjeti elektrik u dëmtua në 617 qendra të banuara, ujësjellësi në 440 fshatra. E megjithatë, deri më 12.7.1999, ishin rikthyer më tepër se 600.000 kosovarë në shtëpitë e tyre. Në këto kushte, kur mungonin gjërat më të domosdoshme, si: strehimi, uji, drita elektrike, ushqimet, kosovarët me zetorët e ngarkuar, edhe pse me defekte, riktheheshin me gëzim e shpresë, të vendosur se do t'i kapërcenin vështirësitë. Sipas buletinit të lajmeve të ATSH-së, datë 17 qershor 1999, një kosovar nga Krusha e Vogël thotë: "Nuk e dimë çdo të gjejmë atje, por duhet me u nisë sa ma shpejt. Jemi mërzitun shumë. Në Kosovë kam shumë tokë dhe dy shtëpi. Mbase ka mbetur në këmbë ndonjë prej tyre. Sa të fusim kokën të gjithë". Edhe vetë studiuesit serbë e pranojnë se shqiptarët

“kanë një ndjenjë të fortë për bashkësinë e fisit dhe të familjes, dhe njëkohësisht tregojnë një shpirt të sakrificës që nuk sprapset përpara asnjë rreziku, a greminë” (Tirta, 2003, f. 364).

Kosovarët prej vitesh kanë emigruar dhe e njohin jetën në Perëndim. Ata e dinë ç’do të thotë të jesh larg vendit tënd, larg njerëzve të tu të dashur, sa e vështirë është të punësohesh, të integrohesh plotësisht atje. Lekët që i fituan në emigracion i bënë me shumë mund e sakrifica. Të punosh në vendin tënd, për vendin tënd, në mes njerëzve të tu – është kënaqësi, është lumturi. Me paratë e fituara investuan në Kosovë, edhe në kushtet e vështira të terrorit serb. U kthyen në Kosovë për të mbrojtur investimet e tyre, por edhe për të bërë investime të tjera... Në kushte më të përshtatshme... Të lirë në tokën e tyre, me vrull të ri, me energji të reja, me shpresa të reja...

Mbyllja

Kanë kaluar plot 16 vjet nga shpërngulja e dhunshme e shqiptarëve të Kosovës nga pushteti serb, por as strukturat e larta shtetërore të Serbisë, as Akademia e Shkencave të Serbisë nuk kanë kërkuar falje për genocidin ndaj shqiptarëve të Kosovës... As nuk janë ndëshkuar urdhërdhënësit dhe ekzekutorët, gjeneralët vrasës, oficerët gjakpirës, ushtarët dhunues, paraushtarakët e droguar plaçkitës e zjarrvënës. U rritën në përgjegjësi dhe u dekoruan me motivacionin “Shembuj të Heroizmit dhe të Patriotizmit”. Kur mungon institucioni i faljes, duhet bërë kujdes dhe duhet treguar vigjilencë e lartë, sepse pasardhësve të Millosheviçit, të Sheshelit, të Arkanit, po t’u jepet mundësia përsëri ushtrojnë genocid ndaj shqiptarëve të Kosovës. Atje e kanë mendjen. Por janë të pashpresë. E kanë humbur përgjithmonë Kosovën. Në Bibël ka një porosi të rëndësishme, të cilën shqiptarët përjetësisht nuk duhet ta harrojnë: *“Kujdesu shumë që të mos i harrosh ngjarjet që i ke parë me sytë e tu dhe që të mos largohen ato prej zemrës sate të jetës, duke u folur për to fëmijëve të tu dhe fëmijëve të fëmijëve të tu”*.

Kosovarët dhe shqiptarët në Shqipërinë e vitit 1913 po largohen çdo ditë drejt vendeve të Perëndimit për një jetë më të mirë. Po largohen nga varfëria, nga pasiguria për të ardhmen, nga korrupsioni që ka hyrë thellë në çdo qelizë të jetës. Nuk është

zgjdhja kjo... Ata duhet të punojnë e të luftojnë në vendin e tyre. Me votën e lirë, me guxim e kurajo, duhet të heqin sa më parë klasën politike të korruptuar e të paaftë, duke i hapur kështu rrugë zhvillimit ekonomik, demokratizimit, rritjes së mirëqenies së qytetarëve dhe integritetit të plotë në BE.

Burimet:

- Braha, Mersin. 2013. *Misioni i djallit*, Tiranë: Kristalina - KH.
- Çabej, Eqrem. 1987. *Studime gjuhësore*, Prishtinë: Rilindja.
- Çabej, Eqrem. *Shqiptarët midis Perëndimit e Lindjes*, Tiranë: Çabej.
- Çefa, Anton. 2012. *Një sprovë e psikologjisë etnike të popullit tonë*, Tiranë: Pakti.
- Gulbrilloviçi, Vaso. *Shpërngulja e shqiptarëve.*, Prishtinë: Liria.
- Delvina, Sherif. *Kosova një mit serb apo një realitet historik shqiptar.*, Tiranë: Eurorilindja.
- Durham, Edith. 1998. *Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe shqiptarët.*, Tiranë: Naum Veqilharxhi.
- Frashëri, Naim. 1977. *Poezi*, Tiranë: Naim Frashëri.
- Grup autorësh. 1995. *Zëri i inteligjencies shqiptare për çështjen kombëtare*, Tiranë.
- Grup autorësh. 1999. *Kosova në vështrimin enciklopedik*, Tiranë: Toena.
- Grup autorësh. 2002. *Spastrimi etnik*, Tiranë: Alben.
- Gjeorgjeviçi, Vlladan. 1913. *Shqiptarët dhe Fuqitë e Mëdha*.
- Gosturani, Xheladin. 1999. *Historia e Albanologjisë*, Tiranë: Alben.
- Haxhia, Shaban. 1949. *Arkivi i Ministrisë së Jashtme*, Dosja 201.
- Juriseviç, Craig. 2012. *Duart e përgjakura, kirurgu në luftë*, Prishtinë: Koha.
- Kadare, Ismail. *Dialogu Kadare - Drashkoviç*, gazeta "Shekulli", 5 maj 2002.
- Këqiku, Hysen. 2004. *Psherëtimë për tokën*, Gjilan: Kurora.